

Rregullimi i fushatave zgjedhore online me kode sjelljeje: shembulli i Maqedonisë së Veriut

Përmbledhje e Aktivitetit



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Me financim nga



Austrian
Development
Agency

Nga shtatori 2022 deri në tetor 2023, ODIHR-i ka mbështetur **Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale** (Agjencia) të Maqedonisë së Veriut për hartimin e një **Kodi Sjelljeje për Sferën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve** (Kodi).

Në këtë kod trajtohet sjellja e partive politike dhe kandidatëve në sferën online, duke përfshirë edhe sjelljen e tyre në rrjetet sociale, gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve. Ai mbulon, gjithashtu, edhe sjelljen online të mediave, verifikuesve të fakteve dhe të subjekteve të tjera që mund të ndikojnë te publiku gjatë fushatave. Ky kod është vullnetar dhe synon të shërbejë si udhërrëfyes për të garantuar integritetin e informimit online gjatë zgjedhjeve dhe referendumeve. Gjithashtu, ai synon të sigurojë transparencën e reklamave online dhe financimeve të fushatave zgjedhore, privatësinë dhe sigurinë e përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve, si dhe mospërhapjen e dezinformatave, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.

Ky kod është një mjet novator për adresimin e sfidave të integritetit zgjedhor në sferën online dhe e para nismë e tillë në Ballkanin Perëndimor. Agjencia e miratoi atë përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe proaktive së bashku me Asociacionin e Gazetarëve të Maqedonisë, Institutin Maqedonas për Median, Këshillin e Etikës Mediale të Maqedonisë, Institutin për Studime të Komunikimit dhe Fondacionin "Metamorfozis". Procesi u bazua në praktikën e mirë dhe në informacione të mbledhura paraprakisht mbi opsionet rregullatore, pasuar nga konsultime të gjera dhe të mirëstrukturuara me të gjitha palët e interesuara. Kjo i jep edhe më shumë legjitimitet këtij Kodi, konsolidon efikasitetin e tij dhe forcon angazhimin dhe ndjenjën e pronësisë ndaj këtij kodi mes aktorëve të interesuar. Për t'u siguruar që dispozitat e tij të ishin në përputhje me çështjet dhe objektivat e identifikuar që në fillim, Kodi iu nënshtrua një procesi rishikimi gjithëpërfshirës.

Ndihma e ODIHR-it për Agjencinë ishte pjesë e projektit **"Mbështetje për Reformat Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor"**, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit. Ky projekt mbështet institucionet dhe shoqërinë civile në përpjekjet e tyre për zbatimin e rekomandimeve të dala nga vëzhgimi i zgjedhjeve.


PROCESI I MIRATIMIT DHE ASISTENCA E ODIHR-it

Ndërkohë që fushatat zgjedhore janë përgjithësisht objekt dispozitash të qarta rregullatore, fushatat online vazhdojnë të mbeten të parregulluara në masën më të madhe dhe tentativat për t'iu kundërvënë kërcënimeve dixhitale ndaj integritetit të zgjedhjeve janë relativisht të kohëve të fundit; rregullimi i sferës online po zhvillohet vazhdimisht në përgjigje të objektivave të politikave të reja. Në këtë kontekst, përpjekjet e shumëfishta rregullatore – duke përfshirë edhe krijimin e një kodi sjelljeje – mund të përfaqësojnë mënyrën se si i trajtojnë vendet kërcënimet e reja që mund të paraqesin rrjetet sociale dhe platformat e mediave online ndaj debatit demokratik.

Në korrik të vitit 2022, Agjencia kontaktoi ODIHR-in me një kërkesë për ndihmë në fusha të ndryshme të rregullimit të medias, duke përfshirë edhe hartimin e disa udhëzimeve për krijimin e një kodi sjelljeje për aktorët kryesorë në zgjedhje mbi fushatat zgjedhore në sferën online.¹ Agjencia u treguar proaktive duke e iniciuar këtë proces të hartimit, shtjellimit, konsultimit dhe miratimit të Kodit. ODIHR-i e mbështeti Agjencinë në këtë proces në disa mënyra.

1. Kjo kërkesë erdhi pas pjesëmarrjes së Agjencisë në konferencën e ODIHR-it, **"Një perspektivë rajonale për fushatat zgjedhore online - Sfidat dhe Mundësitë për Integritet Zgjedhor"**, mbajtur në maj 2022.

MBËSHTETJA E ODIHR-IT



ELEMENTET KYÇE TË KODIT

Kodi trajton rregullimin e fushatave online në përputhje me parimet demokratike dhe praktikën e mira për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, duke mbuluar çështje kyçe si integriteti i informimit, transparenca e reklamave të fushatave dhe mënyrat e financimit të fushatave, dezinformimin, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin. Pika e tij e fortë qëndron tek qasja e tij gjithëpërfshirëse, duke pranuar nga njëra anë natyrën komplekse të fushatave zgjedhore dhe kërcënimet online ndaj integritetit të zgjedhjeve dhe duke angazhuar, nga ana tjetër, të gjithë aktorët kryesorë zgjedhorë.

Kodi përfshin edhe një element shumë të rëndësishëm të rregullimit, përmes krijimit të një mekanizmi mbikëqyrës me shumë palë - Trupin Koordinues - i cili ngarkohet me adresimin e ankesave. Përbërja dhe funksionet e tij vendosen përmes dialogut dhe transparencës dhe të dhjetë janë përcaktuar në një Memorandum Bashkëpunimi të detajuar. Një **faqe interneti dedikuar** ankesave dhe përgjigjeve nxit transparencën dhe llogaridhënien e Trupit Koordinues. Një tjetër element i rëndësishëm novator është procesi i konsultimit mes Trupit Koordinues dhe institucioneve të tjera shtetërore; një mekanizëm që duhet të rrisë legjitimitetin dhe qëndrueshmërinë e vendimeve të miratuara.

HAPAT E RADHËS

Zbatimi i Kodit mund të vlerësohet vetëm pas zgjedhjeve të ardhshme në Maqedoninë e Veriut, të planifikuara për vitin 2024. Atëherë, do të jetë e mundur të nxirren përfundime dhe të vlerësohen arritjet dhe fushat që kanë ende nevojë për përmirësim. Megjithatë, deri atëherë, mund të reflektohet mbi sfidat e mundshme ndaj efikasitetit të Kodit dhe mbi mënyrat se si mund të parandalohen dhe/ose të adresohen ato:

- Është thelbësore që të gjithë aktorët e përfshirë të angazhohen sinqerisht ndaj parimeve të përcaktuara në këtë Kod, duke përfshirë edhe partitë politike dhe kandidatët që nuk e kanë shprehur ende zyrtarisht mbështetjen e tij.
- Është po aq e rëndësishme që procedurat e ankimimit të jenë të shpejta dhe që shkeljet e pretenduara të shqyrtohen drejt. Kjo vlen për të siguruar, nga njëra anë, të drejtën për zgjidhje juridike efikase dhe, nga ana tjetër, legjitimitetin dhe zbatimin e vendimeve të miratuara nga Trupi Koordinues.
- Burimet e dezinformimit janë shpesh aktorë vendas dhe klima e një fushate zgjedhore mund të përforcojë tonet dhe strategjitë e tyre të komunikimit. Është e një rëndësie të jashtëzakonshme që këta aktorë të angazhohen në këtë përpjekje për rregullimin e sferës online.
- Përfshirja e kompanive të teknologjisë është një tjetër element thelbësor. Trupi Koordinues duhet të shqyrtojë nëse kanalet e bashkëpunimit dhe konsultimit mund të hapen me platformat kryesore aktive në Maqedoninë e Veriut.
- Trupi Koordinues do të ketë nevojë edhe për ekspertizë të fortë në analizën e mediave sociale. Takimet sistematike mes nënshkruesve të Kodit për të diskutuar zbatimin e tij duhet të ndihmojnë për të kuptuar më mirë dispozitat e tij kryesore dhe interpretimin e tyre.
- Së fundmi, përmbajtja dhe sjellja në rrjetet sociale mund të jetë e vështirë të identifikohet se kujt i përket dhe grupet private mund të jenë të vështira për t'u monitoruar; mund të pritët që të mos respektohet plotësisht asnjë lloj kodi prej tyre. Prandaj, menaxhimi i pritshmërive është çelësi i garantimit të besimit dhe pranimit të këtij Kodi.

Për të mësuar më shumë, vizitoni: www.osce.org/odihr/wb

Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve apo të Agjencisë.

